



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE  
I SANKSIONEVE

Data: 29 Dhjetor 2021

Nr: 116

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 02, DATË 24.12.2021 TË  
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE PËR VENDOSJE SANKSIONI  
ADMINISTRATIV

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 29.12.2021, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA - Relator  
Elvin LAKO - Anëtar  
Ilirjan RUSMALI - Anëtar  
Koli BELE - Anëtar  
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**OBJEKT:** Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 02, datë 24.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për vendosje sanksioni administrativ

**BAZË LIGJORE:** Neni 21 i “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17, 18, 34, 35, 36, 40, 41 dhe 45 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

### **VËREN:**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 19 të Kodit Zgjedhor dhe në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator në KQZ, ka paraqitur pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore nr. 02, datë 24.12.2021, me objekt: “Vendosje sanksion administrativ ndaj sekretareve të komisioneve të qendrave të votimit sipas listës në lidhjen 3, që i bashkelidhet vendimit nr. 470 të KSHZ”.

Në seancën e vlerësimit paraprak të datës 29.12.2021, ora 12:00, pas relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa nr. 02, datë 24.12.2021 e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i plotëson elementët e formës të parashikuara në nenin 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator në KQZ.

Pas vlerësimit paraprakisht të kriterëve të përcaktuara në nenin 130 të Kodit Zgjedhor, rezultoi se KSHZ legjitimohet në kërkimin e tij, KAS ka kompetencën lëndore dhe funksionale për shqyrtimin e kërkesës në fjalë e cili është paraqitur brenda afateve ligjore të përcaktuara.

Në këtë kontekst, në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, të Komisionit Rregullator, propozohet kalimi për shqyrtim i kërkesës së KSHZ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenet 17, pika 3, shkronjat “a”, 18, 35 dhe 36 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator në KAS,



## V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 02, datë 24.12.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Seanca për shqyrtimin e kërkesës do të zhvillohet në datën 05.01.2022, në orën 13:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Anëtar</b>

